

Skënder Buçpapaj

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-1
1388

poezi

Zogu i bjeshkës



846-1
B 88

SKËNDER BUÇPAPAJ

ZOGU I BJESHKËS

Poezi



11697

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

P A R T I

Kam në zemrën time kaq dashuri dhe kaq këngë,
kam në sytë e mi shkëlqimin e ditëve të tua me
diell,
kam në krahrorin tim aromën e pranverave të tua.

Në buzëqeshjen time, buzëqeshje të dlira e njerë-
zore,
në qenien time ngrohtësia e dashurisë sate prindë-
rore,
në duart e mia fishekzaret e flamujt e tu të festave.

Dua të të buzëqesh me buzëqeshjen e tërë brezave,
që jetuan shekujve me dëshirën për të buzëqeshur,
që të buzëqeshin përvjetorëve e festave.

Parti e lavdishme,
në marshimin tënd
në përvjetorin e tridhjetë.

ME HORIZONTET

*Frrrok Kolë Kaçorri në Kongresin
VI të PPSH.*

Kam marrë me vete horizontet e bardha të galerive,
kam marrë brerima tingujsh kumbues të martelëve,
kam ardhur me livadhet e blerta të malësive,
me gurgullimat e çelura të melodive e të këngëve.

Në zemër të malit i gjeta përjetësish hapësirat
(hapësirat i laga me gjakun që më rodhi curril.)
Te galeritë e bardha si zambakë lulëzofshin minat!
Gjaku im qoftë për ju dhe tërë brezat trëndafil!

I dua brohoritjet e kongresit për horizontet e mia,
se ata reshën për mua brerim fluoreshente martelësh,
me këto pëllëmbë i shtova horizontet te malësia,
se galeritë do të digjen riga të qeshurash tërë
jetën.

Sa herë do të vini, më gjeni te galeritë e bardha,
me horizontet e mia e diellin e tërë horizonteve,
do të flokojnë për jetë borat e ditëve të zjarrrta,
do të interferojnë zërat e mi e të shokëve.

KUR ÇELI ZAMBAKU I PARË

Unë,
zambaku i porsaçelur në këtë pranverë e në këtë
tokë
dua t'i thërras djemtë e vajzat e punëtorët e
ndershëm
të vijnë
t'i mbledhin petalet e mia të freskëta, të shëndetshme.

Kush të vijë,
do t'u tregoj se jam zambaku i parë, që çela këto
petale,
jam zjarr i ndezur që çela këto fjalë.

Kam petale gazin e fëmijëve, të nënave, të njerëzve
të lumtur,
jam zambaku i parë që çela në afshin e ngrohtë të
pranverës

çela në brinjët e egra e tulin e tokës,
bulova në lëndinën e gëzueshme të pritjes së
njerëzve.

Jam zjarr pranvere dhe mos qofsha kurrë,
zjarr komunist në mos qofsha.

Do të mbushem me pjellorinë e arave e galerive,
me krismat e poligoneve,
do të mbushem me rimbisësinë e ujrave e syve të
qeshur.

Çela.

Eni djem e vajza,
ju, punëtorë të ndershëm,
merrni petale,
çela për ju të gjithë.

PËLLUMBI I HEKURT

Simbol i paqes në botë është një pëllumb i hekurt.

Rapsodi Sokol Arifi ia ka caktuar çerdhen në ah,
në të çarë shkëmbi buzë Valbonës.

Unë i kujdesem për çerdhen majë ahut,
ia shtroj me dushk të njomë ahu,
filiza gruri.

I jap të pijë ujë nga të Vrellës së Shoshanit
i jap të hajë grurë nga të Katundit të Paqes,
i porosis qiejt e Shqipërisë t'ia ruajnë fluturimin.

Siç ka dalë nga shkëmbi i çarë ahu,
siç ka dalë nga kokrra e çarë gruri,
ka dalë pëllumbi nga zemra e çarë e popujve.

Tani në fasada, sheshe, shkolla vëreni këtë pëllumb
prej hekuri të kuq.

Hiqeni nga dhomat, librat, qëndizmat
pëllumbin e butë.

Gjersa atomi a napalmi është në duart e agresorëve,
paqa e botës nuk mund të ketë simbol
pëllumbin prej mishi të butë.

KUJTIMI I MOTRËS

Fëmijnia ime
lëndinë jasemine
gjumi.

Motra trevjeçare
më përkund në djep
në lëndinën time.

«Nina-nin djepin me sanë
u bëfsh trim si partizanë.
Nina-nina të përkundi
o Skënder po të merr gjumi».

Bilbil Gjyzari i këngës së motrës
ndjell gjumin.

Ai del nga flokët prej bari të bardhë
të lëndinës
më lyp mua.

Dora e vockël e motrës m'i mbyll sytë.

DJEMTË E MINIERËS SE RE

Punëtorëve të minierës e gjeologjisë në Rrogam Tropojë.

Marsi erdhi me rudinat e mbushura me shkrirje bore,
duke lindur pranverën,
me mugullim dëshirash, dashurish edhe ëndrrash.
Dëshirat, dashuritë e ëndrrat e djemve në marsin e
moshës
kanë zogjtë vocrakë që i nxjerr pranvera nga tulet
e rudinave.
Zogjtë i kanë cijatjet e njomura me zhurma toke e
kromi
cijatjet janë të lara me çuçlonët e kulluar që i lajnë
rrëgallat e bjeshkëve
e gati i bëjnë për mëngjezin më të ri.
Djemtë i kanë këngët e tyre,
në ato këngë është një qafë mali me lulekuqe
dhe një luginë me qershi.
Lulekuqet për të pritur agimet në qafëmali,

qershítë pér t'u dridhur nëpér meloditë e këngëve.
Kënga me gjak deri në gju e kallinj gruri deri në re,
me male të rrahura nga stuhitë e breshëri,
me udhë të blerta ku udhëton dielli,
me lëndina lulesh e pemë që i luhat era,
era që zbret grimca shiu, lule, aroma e këngë zogjsh
 të çiltëra
që i dërgon në zemrat e njerëzve.

Këngë sondistësh
me prille dashurie e korrikë brenda kokrrës së grurit,
me zhurma sondash, vajra e metal të ftohtë,
këngë që të kujtojnë sy të rimë, buzëqeshje të rime,
dasma të rime,
si qielli.

Jemi malësorë
dhe malësorët janë të heshtur.

I ngajmë një mëngjezi të egër bjeshkësh.

Po hyre nëpér rrugën e mëngjezit të egër,
do të gjesh ditë të butë në shpirt.

Ne jemi rudinat, pyjet, përrenjtë
në njohjen e parë ngjajnë me tinguj lahute,

shpirti ynë
u ngjan tingujve të lahutës e të fyellit.

Jemi burrëuar;
trupi leshtor na e tregon afërsinë me shkëmbin
që e mbulojnë myshqet e gjelbra.

Ikim mesnatave e përballojmë gjumin mbi sonda.
Nënët e kuptojnë
se u kemi dalë nga duart.

Janë të shqetësuara,
shikojnë në dritare, në udhë
se mos u sjellim nuse.
Nuset tona mundohen t'i shohin në ëndrra
dhe në sytë tanë.

Tani humbim orë e humbim net
pas atyre që do të jenë nuset tona.

Në ballkonet e apartamenteve,
në dritare e në kopshte
vajzat rritin lulet e takimeve tonë.

Jemi më të bukur e më të lumtur,
sépse hyjmë nëpër net minierash e sondash,
sepse hyjmë nëpër ëndrrat e kujtimet e vajzave.

Ne dashurojmë, se dashurojmë tokën,
ne dashurojmë, se dashurojmë njerëzit.

A K T U A L E

Era me shi të kuq dallgëzon flamujt e kuq të revolucionit botëror, dallgëzon Oqeanin e Qetë, Detin Mesdhe, Oqeanin e Revoltës zezake.


Sirena fabrikash gjigande qëllojnë me forcë hapësira kontinentesh me gjarpërinx mijrakrahësh urie, lodhjeje, sëmundjeje, etjeje.

Gjaku dhe djersa e proletariatit pushton avenjutë, sheshet, katet e larta me demonstratë, qyletet e paralizuara nën këmbët miliardatonshe të kolonave kilometrike të demonstratave.

Nën furçën e zezë të netëve me uniformë policie
Nju Jorku, Moska, Londra, Parisi, Tokioja,
me buzë të shtrira në sipërfaqet e shesheve, në fa-
brika, banka
rënë përmbyss, me gojë miliarderësh
gëlltisin gjakun e djersën.

Gjaku e djersa të shndërruara në stërlina, dollarë,
rubla,
kërcasin në gërmazët e qyteteve.

Ne nga Shqipëria besojmë:
do të bjerë perëndimi gri me hi e shkrumb
në gërmadhat me pala tulj e dhjami
të trungjeve pa koka, pa qafa, pa barqe,
siç e pamë një herë,
më 1944.



ZOGU I BJESHKËS

Cicëriu zogu i vogël i bjeshkës
e më fali lulet e malit,
e më fali larat e borës,
e më fali flladin e ashtës
e më fali zhurmat e sondave
e më fali zërat e kooperativistëve.

Cicëriu.

Cicëriu zogu i bardhë i bjeshkës
e më fali verën.

TETË DITËT E VALBONËS

Tetë ditë qëndrova pranë e pranë me ujrat e Valbonës,
tetë ditë u rroka me ujrat dhe zhurmërimën e kaltër
të ujraye,
tetë ditë hodha themelet e mirëmbajtësit të rrugës,
ku ujrat do të bijen, të përplasen e të thyhen.
Bisedova me ujrat fjalët më të këndshme që do të
gjeja.

Tani do të iki nga Valbona, nga brigjet e saj të
zhurmëshme;
do të iki dhe, kudo që të jem, do t'i shkruaj asaj që
mabeti këtu, në gryka e lugina:

Eja më tako, e dashur
atje ku ngrihet një kantjer i ri.

MANUSHAQET E KUQE

AZEM DIN KËRNAJËS

Më 6 gusht 1972 ra manovratori i maqinës së shpimit, peshoi mbi të masivi shkëmbor i tunelit tonë. Me gjak e shkëmb fjalët e fundit.
Lamtumirë!

Sytë iu mbushën me liqenin e Hidrocentralit të Fierzës.

Na i zgjati duart e përgjakura përmes masivit shkëmbor, na i fali lulet më të bukura në gjithë botën, dy manushaqet e kuqe pesëpetalshe.

Më 6 gusht 1973 shkuam në tunel,
pas një viti ndarjeje çelën nga betoni manushaqet
e kuqe.

Me të dhjetë petalet
t'i tokim fort duart,
shokë të turnit të natës.

SIKUR TI TË JESH LUMTURIA

Qyteti i takimit tonë i ka ndezur dritat,
pishat shikojnë mes halave si qerpiqë natyrën
e qytetit,
pas betonimit nuk ka takim më të këndshëm se yni
e drita më shumë do të ketë takimi ynë e kallo
më shumë.

Po sikur vetëm ti të jesh lumturia ime,
që tanë do ta lija këtë qytet të vogël takimi,
pishat mes halave do t' të shikonin vetëm ty.

(S'i dua qytetet pa lëvizje, qytetet pa takime.)

Në qytetin pranë kantjerit tim njerëzit lumturinë
e duan me kallo,

në turne e betonime ngrënë qytetin e ri me drita
e kallo e dashuri.

Në qytetin e ri njerëzit gëzohen për lumturinë e
shokut.

Për lumturinë e të gjithëve.

Qyteti i të gjithë të mirëve.

**U PËRKUNDËN MISRAT NË KRAHARORIN
E MIXHËS**

U përkundën misrat në kraharorin e mixhës ditën e
inaugurimit të rezervuarit,
u përkundën misrat kur mixha hapi portën e misrat
u njomën me ujra.

Lëvizën ujrat dhe mixha im, që i ka pritur kaq të
bukura, si dikur malësorët e rinj nuset,
mori kaq shumë ujra, sa të njomen gjithë misrat e
etura për ujë.

Se mixhës tim i ka plasur në këmbë e në kraharor
toka e etur për ujë,
se mixha im, bujku më i mirë i fshatit,

ka kaq misra e aroma misrash tē etura pér ujë nē
kraharorin e tij,
sa do t'i duhen gjithë këto ujra
që, nëpér plasaritjen e tokës së misrave tē tij,
tē mos pushojë kurrë kënga e ujrave.

R R È M B I M I

(*Motiv i lashtë*)

Na u tundën nëpër duar grunjat.
Dritë e hënës grunjave u thye,

i vërtitëm dreprit nëpër grunja
dritë përmby grunja, për nën grunja hije.

Grunishtat lëviznin, tundeshin nga flladi,
yjet regëtinin si të zënë nga malli.

Hëna si një drapër pranë u pushonte
korrësen e yjeve kush e vodhi sonte?

Prapë përmby grunja e derdha shikimin,
befas m'u kujtua e dashura ime.

Drapërin e mora, vetëm i lashë shokët,
nën dritën e hënës e kërkova korrësen.

Grunjat pranë m'u tundën, po kërkonin drapër,
asgjë s'më tregonin për korrësen e dashur.

Pak më larg në grunja, poshtë në një arë,
e gjeta papritur drapërin e saj.

O, ç'ma kishin vjedhur korrësen e dashur,
grunishtat larg saj po kërkonin drapër.

Natën nëpër hënë ma vodhën ata,
drapërin e dashur grunishtës ia la.

Drapëri në grunja, në tokë pushonte
korrësen e grunjave kush e vodhi sonte?

Bajraktari vuri sonte katër hije,
një drapër la në grunja, një drapër në yje.

Korrësen ma vodhën dhe në zemrën time
mbetën grunja të pakorrura dhe yje.

DËSHIRA PRANVERE

Viseve të mia
shiu u derdh papushim mbi bardhësinë e borës
dhe toka nëpër davaritjen e mjegullës dhe laritjen
e borës ndjeu duart e ngrohta të shiut.

Sot nga shpatullat e maleve, nga rrëzat e bjeshkëve
rrëshqitën në shtratet e lumenjve copërat e bardha
të borës dhe vrulli i ujrave,
e lumenjtë e ndjenë veten më të pushtetshëm e të
domosdoshëm në këto male.
Pastaj dielli dalëngadalë e me naze derdhi rrezet e
tij majëmaleve, shullëreve e gjer në fryrjen e
lumenjve.
Toka ime thithi me etje ngrohtësinë e tij të ëmbël
e të shëndetshme.

Nesër mbi këto male,
nga kreshtat gjer tek rrëzat e bjeshkëve
do të mbijë mundimi e gjatë i këtij shiu të ngrohtë,
do të mbijë ngrohtësia e artë e reflektuese e këtij
dielli,
malet do t'i shohin ëndrrat e para të blerta me dritë
e me dritë e ngrohtësi do të zgjohen malet e
mëngjezeve të rinj arave e kantjereve,
sonte viseve të mia, njerëzit ranë me dëshirat më të
bardha të të gjithë pranverave.

N G J A S I M I

Dashuria jonë dhe ëndrra e mirë e foshnjës s'mbetet pa zbuluar.

Foshnja, kur sheh ëndërr të mirë,
qesh në ëndërr.

Në të qeshurën e foshnjës
patjetër është nëna.

Në të qeshurën tonë
është dashuria.

M A L E

Do të vij, se më mori malli për flladin e diellin e
bjeshkës
do të vij, se më mori malli për zogjtë dhe lulet e
burimet e bjeshkës.

Do të vij se kanë mall për mua rudinat
dhe, kur të ngjitem unë, do më ndalin me duart e
vogla lulet e rudinave.

Gjumi ndoshta do më zërë midis luleve
nga malli për lulet.

Ti, vasha ime, në ardhsh në rudina
e në më gjetsh në gjumë,
lagëm gojën me pak ujë të bardhë, si në lirikat
popullore.

Kam mäll shumë,
për gjithshka bjeshkëtare malli më ka marrë.
Në ardhsh, moj vashë,
në më gjetsh në gjumë,
lagma gojën me një ujvarë të bardhë.

NA DOGJI MALLI PËR TË RËNËT

poemë

Mësuesit të Merituar, Isa Selim Bajraktarit

Na dogji malli për të rënët!

Tri dekada që kur dhembjen e mallin për ta e ndaj-
më në mes nesh.

E ndajmë me malet tona, kooperativat bujqësore dhe
këngët,

nga malli ynë marrin fëmijët tanë, shkollat dhe poe-
mat.

VG 196

Pranverat e tri dekadave që ne sjellim lule,
sjellim dhembjen e dy milionëve e vëmë mbi
mbi këngët tona ngritur për ta.

Ruajmë kujtimet dhe shembllën që na e lanë.
Fotografitë që nxorën në brigada, në kufi, përfytyrimit tonë të luftës e të mbrojtjes së lirisë.
I kemi në vend të të rënëve, në vend të fjalës së tyre, amanetit që na e lanë para se të mbyllnin sytë.
T'i japim atdheut stinën e komunizmit, të ruajmë amanetin e kuq të gjakut të derdhur.
Shembëllimi i kuq, na thanë, ju duhet juve përkufijtë, industrinë, festivalet,
Për çeljen e lules së Republikës pranë valëve të Adriatikut.

Ne përmallohem sa herë shkojmë në muzeume prekim me duart plot kallo këmishat që mbanin në luftë, në kufi apo atë ditë që reforma ua shpërndau tokat e pasurinë të varfërve.

Ja vendi që e kanë grisur plumbat.
Kërc éshtë hapur plaga në koskat e tyre e kanë rrjedhur lulekuqet
(Ato kanë mbirë pranë çerdheve të fëmijëve dhe reparteve ushtarake).

Këtu ishte gjoksi i tyre
këtu rrihte zemra, sa grushti i tyre i ngritur kundër fashizmit,

të rrahurat e zemrave të tyre
mund t'i dëgjosh ende pranë një shkëmbi a burim
mali.

Prekim me duar llogoret, pozicionet e luftimit, datën
e rënies e të varrimit
dhe e ndjejmë tek gurgullon rruga e parë e këngëve
tona.

Kudo që shkojmë,
në kufi, në arë, në turnin e tretë,
ruajmë nderin e të rënëve, fytyrën e të rënëve dhe
porosinë e të rënëve,
ruajmë bollëkun e gjakut të tyre në damarët tanë,
në fëmijët, minierat, paradat e kongreset,
ruajmë ekzistencën e përjetësinë.

Na mori malli për ty, o Isë!

Vjen prilli e vjen maji i çdo viti
çel manushaqe e trëndafile mbi varrin tënd e kuj-
timin tonë.

I ruajmë fotografitë e lules së rinisë sate:
Qëndron në këmbë me kostum tropojas, qeleshe në
kokë,
shikimin e kthjellët, drejtuar nga socializmi dhe nga
partia.

Në to është qeshja jote e ëmbël, shikimi ende i
kthjellët,
s'ndalemi pa t'i puthur sytë e shikimin, fytyrën e
buzëqeshjen.

Ata që vdesin për atdhe thonë se janë kudo,
ty të duhet të vesh sa në kufi, sa tek nxënësit, sa
në mbledhjet e rinisë.
Ne të kemi dëgjuar tek këndoje me korin e pionie-
rëve e thërrisje me ushtarët «Ushtria-garancia!»

E dimë

Xibri s'të ndal, kur ke mall për nënë, për vëllanë
a për shokët;
ty që s'të ka ndalur as plumbi, as lodhja, as viset e
largët.

Vetë na ke thënë se njerëzit s'i ndajnë luftërat, as
vdekjet, as malet as vitet.

E doje tokën si nënën e thoshje sa herë:

Çdo kokrrizë dheu e ka gjakun tonë e djersën tonë,
çdo grimcë guri ka eshtrat tona.

Njëqind herë po të vdes, sërish kjo tokë do t'më
lindë,
se shqiptarët e kanë këtë tokë të lindjeve e të vde-
kjeve.

Në gjakun e vet toka ka besnikérinë pér ne, pjello-
rinë pér ne dhe pavdekësinë po pér ne,
ne kemi besnikérinë pér tokën, pjellorinë pér tokën
dhe pavdekësinë po pér tokën.
Vetëm ajo ka të drejtën mbi ne të na vdesë e të na
lindë.

Xibri. Trajta të rrumbullakuara malesh.
Malet, kur merrnin frymë,
dridhnin cipën e kaltër të qiellit të mbushur me re të
bardha e mëngjezë
mbi shtëpitë me mure gri të malësorëve.
Avullonte gjak toka, avullonte barot, predha nga
shtigjet, lëndinat e muret,
ndërsa nën tokë, në rrënje të barit e të punëve, në
themele të shtëpive e nën murana
lëvizte i përjetshëm trupi i të rënëve.
Nga fletoret e nxënësve të Ndrec Ndue Gjokës e
Isa Bajraktarit
në hekurudhat e para, në aksionet e rinisë, në koo-
perativat e para bujqësore
në gërmat e gazetave tona të para
akoma ndjehej aroma e luftës, e barotit të luftës.
e tymit dhe plagëve të luftës.
Ndërkohë nga sytë e të rënëve çelnin lulet, bari e
pemët,

nga shtëpitë, urat e rindërtuara, gropat e mortajave
çelnin pranverat e ditët.

Njerëzit u vinin emrat e të rënëve fëmijëve të parë
të partizanëve të kthyer nga brigadat,
ndërsa fëmijët që bandat e kriminelëve ua vranë
baballarët para shtatë muajsh,
ua merrnim emrat baballarëve të tyre.

Net të lehta si hije kumbullash mbulonin reliefet e
buta.

Në net të tillë,
ku ëndrrat e ish - partizanëve, aksionistëve, të rënë-
ve, fëmijëve, udhëheqësve,
çelnin në dritaret e qyteteve të rinj dhe nën kupën
e kthjellët të qillit,
qeveritë imperialiste filluan të çelnin ëndrrën e luf-
tës së tretë,

nxirrin nga varret

fashistët

dhe militarizonin shtetet.

Malësive ua rrënqethnin reliefet ziqret e dervishle-
rëve
që donin të na i shqetësonin ëndrrat, të na e mbu-
lonin zërin tonë.
që gufte nga qytetet, tokat e reja, varrezat dhe
monumentet e heronje

dhe të mos i dëgjonin çapat e zbetë të kriminelëve
që mbushnin vragat e thella të shkrepave.

Mësuesi Isë vinte i lodhur nga pagjumësia në klasë,
se netët i harxhonte duke i ndjekur kriminelët që
donin të na i vrisnin mëngjezet.
Shfletonte librat, fletoret tonë, shtypin e partisë.
Gërmat e gazetave, librave e fletoreve, si gurë gri,
që binin erë tym, barot e agim i ri bjeshkësh,
i ngjanin me gurë pozicionesh luftimi
nga ku mund t'i qëllonte ditë e natë ata
që i ruanin në armët e ëndrrat e veta errësirën për
ne.

Na dogji malli për të rënët!

Njerëz, sa herë që të ndjeni mall për të rënët,
sillni lulet e pranverave mbi dhembjen e kësaj poeme
Po bëhen tri dekada,
dhe nxënësit e Isa Bajraktarit, duke dërguar lule në
varrin e mësuesit,
edhe poemës sime i kanë sjellë lule.

P A B J E S H K E T

Dy malësorëve që u varën në Gjakovë
nga turqit në kohën pas Lidhjes së
Prizrenit.

Gjithë jetën mbi kokë pak qiell të kaltër,
gjithë jetën nën-këmbë vetëm stërrall bjeshke.

Po një ditë s'ua lanë qiellin e kaltër
as stërrallin e bjeshkës.

Një ditë s'ua lanë ajrin e lirë
ajrin e hollë,
ajrin e egër,
ajrin e brishtë të bjeshkëve
që një gem pishe na tundi tërë jetën,
të gjelbër.

Ju, mbi Gjakovë, pa qiellin, stërrallin e gemin e
gjelbër

ju, mbi Gjakovë, si dy mjegulla të lara mbi shkë-
mbinj,

që varen përmbi stuhi
nga një mëngjez vjeshte.

Një litar

u luhat mbi qytet si elbaze e gjelbër,
që mbi stërrall të rrënë troshitjet e djepeve,
që ajër të lirë të pijnë brezat e bjeshkët,
që ajër bjeshke të pijë çdo pishë e gjelbër.

TOKËS E GRUAS

Ju kam dashur shumë, tokë dhe grua.

Këta tre vjet të intimitetit me ju,
m'i bëtë të njojur përrenjtë, shpellat, qafat;
shpirtin e bukurinë tuaj më falët.

Gjej mostrat e tokës që nga paleozoiku,
kthehem i lodhur në dhomën time,
gjej gruan të një moshe me mua,
unë, inxhinieri gjeolog.

Falemnderit, tokë!
Falemnderit, grua!
M'i falët sekretet.

Në këtë zonë do të ngrihet miniera
dhe uzina e shkrirjes së boksidit.

Toka ime do të lindë metal,
gruaja ime-metallurge.

Tokë, për këtë jam lodhur prej tre vjetësh!
Grua, prej tre vjetësh këtë e kam pritur!

VAJZËS, QË DO TË BËHET ELEKTRICISTE

Ti do të bëhesh elektriciste, Vjollca!

Linjat elektrike të gjitha bjeshkëve më duket se
kalojnë nëpër duart e tua,
frushullojnë linjat nëpër këngën tënde mbi bjeshkët
e mia.

Kënga jote, sa herë në ngjitje përplas flatrat, nga një
flatër merr.

Kur mbrëmjet e bjeshkëve t'i çelin qepallat mbi
lumturinë tonë,
do të na pëlqejë të shohim si na shfaqin mbrëmjet
gëzimin bjeshkëve.

Ndoshta disa çaste mbrëmjet, si nuse të turpëshme,
do t'i pulitin qepallat e nën to bjeshkëve gëzimin
do t'ua fshehin.

Ti do të mësyje atëhere drejt linjave që zgjaten
mbi bjeshkët e mia gjer në qenien time.

Kur mbrëmjeve t'ua çelësh përsëri qepallat,
s'do të dija në është zbehur nga të ftohtët a e sku-
qur nga gëzimi fytyra jote krejt.
Veç do të doja që fytyra jote t'u shfaqet nëpër dhoma
njerëzve
në llampat e bardha,
Vjollca.

Sado larg nga njëri-tjetri të jemi,
zgjatimi i linjave mbi bjeshkët do t'na lidhë.

TAKIM ME PRANVERËN

Kur i ndeza sonte minat në trase,
të gjithë zogjtë u trembën e u ulën në qytet.

Njerëzit shëtitën deri vonë.
Vetëm mua më ndoqi era trotuareve, rrugëve, gjer
diku jashtë qytetit,
vetëm unë do të takohesha me pranverën.
Dikur, vonë, u takova me pranverën që më priste
në blerimin që do të bulojë nesër.

Ia mora duart nëpër duar e këto m'u bënë të gjel-
bra.

Kur t'i ndez nesër minat në trase,
zogjtë, të trembur,
do të ulen në flokët e faqet e gjelbrasës
do të ulen nëpër flokët e mi,

nëpër faqet e mia do të ulen zogjtë
e do të cicërojnë
e do të cicërojnë.

U takova sonte me pranverën e i fola për të gjithë
ju që ju njoh e që s'ju njoh,
eja, i thashë, se njerëzit të presin për të mbjella
të reja e dashuri të reja.

PRANË VARRIT TË MALAZEZIT

Në Gri, Tropojë

Të vranë gjyshërit e mi. Ti dhe Velika kishit dasmë
në pranverë.
Lulet prisnin të çelnin e zogjtë t'i derdhnin cicëri-
mat lumë,
po lulet çelën për të tjera dasma e zogjtë cicëruan
për të tjerë,
veç Velika jote priti dasmën tënde, që s'do të vente
kurrë.

Ti s'doje të vije. Po ja që erdhe e të vranë gjyshërit.
kishe mjaft viset e tua, njerëzit, Velikën, arat, kal-
tersitë,
veç pa to do të mbeteshe dhe ato do të mbeteshin pa
ty,
krajl Nikolla do të vriste me grunjat, ëndrrat dhe
Velikën.

Mendoje ikje të shpejtë. Gjyshërit të vranë e kurrë
nuk ike.

Të vranë viset e atjeshme, grunjat që i le, Velikën
që të priste,
se ndryshe lavdinë e krajl Nikollës s'kishin si të
vrisnin.

Ti u vdiqe grunjave, lavdisë së krajlit edhe viseve,
veç Velikës sate, malazezes sate nuk i vdiqe.

Ikën malazezët. Të hodhën përsipër një copë dheu
të huaj,
kaq i rëndë qe ky dhe, sa nuk të la që të ikje.
Të ishte dheu yt, do t'i dhimbeshe dhe s'do të
mbante një muaj
do të shkoje tek shtëpia, kopshtet, ujrat, Velika që
të priste.

S'të priti kush. As njerëzit, as stinët, as viset e
atjeshme
as krajli pa lavdinë,
veç e dashura jote qe besnike, Velika jote malazeze
në dritare të priti gjersa u thnj.

Të priti në dritare Velika malazeze,
asnje bulim pranvere s'të dërgoi atje, asnje brerim
dimri,

lulet çelën për të tjera dasma e zogjtë cicëruan
për të tjerë,
vitet nuk u sollën gjë, veç Velikës pritje,
në pritje tek dritarja u thinj ajo e ty t'u thinj
kujtimi.

Ju do të vinit shpesh në tokën tonë;
malazezët do të vriteshin nga gjyshërit e baballarët,
po mirë që të vranë ty e lavdinë e krajl Nikollës,
ndryshe malazezet nëna e Velikat do të mbeteshin
në dritare.

Spasitë qëndru fëmijëve, njëdita qëndra është
stafiq bë

o jashtë më lindja e tij, qëndra e tij, qëndra e tij

qëndra e tij, qëndra e tij, qëndra e tij, qëndra e tij

qëndra e tij, qëndra e tij, qëndra e tij, qëndra e tij

MOTIV I RI

Këtu do të lindë qyteti i drunjtë i sharrëxhinjve,
do të ketë shtëpi druri,
rrugë të shtruara bukur me bujashka molike,
projektorë të fuqishëm nëpër rrugë.

Që tani qyteti i ri i sharrëxhinjve
më njeh mua.

Ky qytet prej druri do t'm'i japë të gjitha da-
shuritë.

KAM DALË SONTE, PO TË PRES TY TE BREDHI

Ti do të vish nga aksioni sonte, vashë e dashur,
bjeshkës së vettuar do të ngjitesh natën vonë,
e gëzuar dhe e trembur do të jesh nga bukuri' e
ashpër
tek bredhi ku burimi po rri zgjuar e hëna po
pushon,
ti do të vish,
ku rruga nëpër brinja ngjitet me zor.

Prandaj të pres tek bredhi që luhatet,
duke mbajtur në gji letrën tënde të fundit,
kur ndihet veç fëshfërimë e pyllit natën
e murmuritje e pérroit si një bisedë e largët,
kur dritat fiken dritareve të katundit.

Ti do të vish, bashkë do të rendim rrugëve të gurta,
do t'i trembim zogjtë nëpër gjethet,
xixëllonjat do të ndizen pyllit gjethegjelbër natën,

kur përzihet fëshfërima e pyllit e shushurima e
lumit,
kur qentë të lehin fort rrugëve të katundit,
do të vij me ty gjer te babai i ashpër.

Unë do të pyes për ditët aksioniste
për «S-të» që ke vënë gjoksit e krenohesh,
për vashat që përtimin lënë e nëpër turne zbresin,
për hekurudhën që çan tejpërtej shkëmbenjtë
dhe e di se s'do të merakosesh
pse s'do të pyes fare për gërshtetin.

Ti do të vish
dhe frikë mos ki kur të vish nga bredhi,
aksioniste,
kur flladi i ngrohtë si mall puth bjeshkët,
kujtomë mua dhe dije:
te bredhi ynë s'ka xhinde, as lugetër.

1969

O JU, KORBA, QË MË HANI

(Motiv kurbeti)

Në dy sytë e mi
ulen
dy korba.

Malet me borë. Korba! Mos m'i ngani sytë!
Në njërin është gruaja. Në tjetrin motra. Në të
dy nëna.

Gjaku me zhurmën e shkrirjes së borës del në
pranverë.

Korba!
Mos m'i ngani sytë!

Në sytë e mi do të rriten
muret e shtëpive.

ËNDERR E NDEZUR E NJË NATE ME DRITË

Mbrëmë,
malet s'e lanë pa lëkundur me brryle njëri-tjetrin
për t'u kënaqur me ndonjë histori të
hershme,
ndërsa mbrëmja kishte mbështetur shtatin e ndezur
mbi gjoksin e maleve.
Mbështeta ballin mbi gjoksin e kësaj mbrëmjeje.

Mbrëmë
në lumturinë time e ndjeva veten si të mundur,
kur profili i mbrëmjes u shndërrua në profilin e
vashës që dua;
ajo flokët e ndezur i shpupurisi mbi qenien time,
qerpiqët e ndezur m'i zbriti mbi mollëzat e faqeve.

Pastaj nëpër duart e mia, në trupin e saj
unë pashë foshnja me buzë të ndezura
tek thëthinin sa mundnin qumësht dhe dritë.

DHEMBJE NËNE

Asim Vokshit

Sa herë klith Spanja nën thundrën e Frankos,
të rënët e botës në Spanjë ndjejnë dhembje.

Shqipërisë i dhemb mishi i Asim Vokshit,
në Spanjë.

K O R B A T

Krrok, krrok, krrok...
Thika të zeza që nuk i ngulen bjeshkës,
gurë të zinj që nuk i tret toka.

Korbat dhe krrokatjet lëshojnë hije të zeza
që duan dikë të plagosin.
Thonë se korbat presin luftëra
dhe ndjellin kobe.

Thonë se kobet krrokatin si korbat
ngulur mbi stivat pa jetë të ushtrive;
kobet zi si korbi.

Ne s'u trembemi as luftërave as kobeve,
na tremben luftërat, kobet dhe korbat e sheku-
llit.

Krrok, krrok, krrok, krrok...

Notat e zeza tē korbave lēshojnē shi tē zi
nga pentagramet e zeza tē kobeve.

Krrok, krrooek...

Korba hēngērshi kokēn tuaj!

SHIU I PARË

Sonte midis pyjeve si pulëbardhë u shfaq kjo qytezë,
sonte pishat u përkulen mbi qytezën e bardhë
si të çuditura nga mysafirja e papritur,
derdhën mbi çadrat tona tërë pjalmin e gëzimit të
tyre
dhe qyteza e ndjeu mikpritjen e tyre të gjelbër.

Kjo është nata e parë e qytezës së sektorit
«Ruga-Ura».
Sonte djelmoshat kënduan këngët e para në këtë
qytezë, sonte
ato do t'i shohin ëndrrat më të bardha e më të
bukura në jetë.

Nesër nëpër agimin e kësaj qyteze
duart e djelmoshave do të zgjaten
drejt gjelbërimit të pishave dhe ahavet

drejt zgjatimit gjarpërues të rrugëve ndër
shkëmbinjtë,
drejt mëngjezeve e mbrëmjeve të qyteteve
e fshatrave.

Ky është shiu i parë që ra në këtë qytezë.
Shiu trokiti sa mundi gishtërinjtë mbi çadra
nëpër tërë mbrëmjet
dhe sonte ne ndjemë
mollëzat e buta të gishtërinjve të shiut të na i
gudulisin ëndrrat.

UKSHIN RUSTEMIT

Dëshmor i Brigadës së 25-të Sulmuese

Jeta jote e lartë,
sa mali i Judovnikut
ku të vranë nazistët.

Vdekja jote e bukur,
si qyteti i Mitrovicës
ku të varrosën shokët.

Pavdekësia e re,
si qyteti Bajram Curri
ku të prehen eshtrat.

Me 28000 dëshmorët
ia bëtë kurorë eshtrat
monumentit të lirisë.

200 dëshmorëve të Tropojës
kurorë ua bëmë pranë eshtrave
lulet e Bytyçit të ri.

Për Shqipëri iu linde nënës,
i vdiqe nënës për Shqipëri.

... türkiliq etti. O
... mepil 1031 n ədətliyərək bəzən qədimləri və mədəni
... türkənən əməkdaşlığı ilə əməkdaşlığı və qədə
... əməkdaşlığı ilə əməkdaşlığı ilə əməkdaşlığı ilə
... əməkdaşlığı ilə əməkdaşlığı ilə əməkdaşlığı ilə
TE KY LIQEN

Tek ky liqen akullnajor patäm ardhur ne tē dy,
kötü ku rudinat vijnë e ulen rehat tek liqeni.

Atë ditë horizonti si sot ish i rimë,
lulet i varnin kokat me mendime tē bardha nēpér
bar,
retë pluskonin nēpér liqen e zogjtë ciceronin nēpér
ajér.

A mban mend,
një grigje e bardhë delesh u ngjit atje ku puqen
qiejt me bjeshkën
kur u dergjën,
morën me vete një grigje resh tē bardha si delet.

O, të pata thënë,
sikur të rrëmbeje në sy kaltësinë e këtij liqeni
dhe e rrëmbeve ti liqenin në sytë e tu
t'i rrëmbeu ty liqeni sytë
që, kur të t'kem ty e mos ta kem liqenin,
ta gjej liqenin në sytë e tu
që: kur mos të t'kem ty, t'i gjej sytë në liqen.

Kur qeshnin sytë e tu, e dija,
atje në bjeshkë kaltërsia e liqenit qeshte nën dritë,
kur sytë e tu mbylleshin në gjumë, e dija,
liqeni kish hedhur përsipër gjithë muzjet e retë
e bjeshkës.

G J A K O V A

Gjakovën desha ta shikoja nga një mesditë
bjeshke,
mjegullat mbi të s'më lanë.

Gjakova,
gjak.

Mjegullat kullojnë gjak,
kuqen fjalët, njerëzit
që rendin.

Çkaherë toka e kuqe dhe qyteti i kuq
dolën nga gjaku.

Gjakova,
belbëzim vigan gjaku
i dheut.

Gjakova,
dhimbë e ngurtë
që u mbeti në fyt
shekuje.

Gjakova deshi të më shikonte nga një mesditë
vere
gjakrat në sy s'e lanë.

TAKIMI I PARE

Sonte

që një punëtor i brigadës sonë do të shkojë në takim me të dashurën, djersët që na rrokullisen nëpër faqe janë petalet e një gëzimi të madh, që ne duam t'ia dhurojmë këtij shoku për takimin e parë. Të qeshurat tona janë më ndryshe, më të çiltëra edhe stërkalat e lumit nuk do të bijen në lumë e të ngrihen stërkala, po do të ngrihen stërkala e do të mbeten lule.

Lule, lule kemi mbledhur kaq shumë
nëpër sytë tanë,
nëpër të qeshura dhe nëpër cicërima
kemi mbledhur lule
sonte që një punëtor i brigadës sonë do të shkojë në takimin e parë.

UJVARA NË KLISYRE

Çdo pranverë ujvara në Klisyrë del nga shpella e
qartë
shtatin e hollë e thyen pas shkëmbinjve të ashpër.
Del ujvara,
copë e thërrime e bën trupin e saj.

Më ngjan kjo ujvarë si vajzë e rënë në kohën e
turqve.
Mali i Klisyrës që e mban në zemër
çdo pranverë i jep jetën dhe vdekjen njëkohësisht.

A ndoshta në zemër të malit e zë malli për ne
dhe, duke dalur në pranverë, ajo mund të çmallet
vetëm duke e thërmuar trupin pas shkëmbinjve të
dashur.

Çdo pranverë ai mal në Klisyrë qet pavdekësi.

P I

I paske marrë me vete Rivierën me brigjet
dhe valët e Jonit i paske në sy.

Dhe unë pi,
pi Rivierën e blertë me fëshfërima agrumesh,
pi brigjet me zhurma e melodi deti e toke,
valët e kripura të Jonit.

Pi.

Pi shumë, sa të më thithin buzët e etura,
sa të mbushet kraharori i gjerë.

Që në buzë të kem përditë ditë të bruzta Riviere,
aroma të çelura, të lagura deti,

që tē kem mbrämje, që bijen tē flenë te deti,
që bijen tē èndérrojnë te deti,
që bijen tē flurojnë te deti,
tē pérkunden,
tē pluskojnë te deti.

Pi.

V A J T O R J A

Pranvera ku kishim hyrë qe shumë e re,
siç qe shumë e re Republika e kënga «Lule Sofo,
lule djalë».

Po pse fërfërinte ai sofrabez si copë nate.
që vishte vajtoren hipur mbi kalin e zi?

Përjetë ky kalë i zi ka trokuar mbi vdekjet tragjike.
Kjo vajtore gjoksin e plakur e sofrabezin e zi, quell
e ka bërë.

Shpalosej klithma e vajtores mbi kullat tymosura,
të mrrollura,
që donin të thërrisnin me frëngjitet: «Epo, duhej
vrarë!»,
mbi klithmat e të vrarëve për gjak e dashuri.

Vajtorja mbi kalin e zi!
Kjo vajtore është lëkundur mbi kalin e zi të she-
kujve me sofrabez të zi që dridhej si britmë,

janë lëkundur vëllezërit e vrarë në pusin e gjakut,
janë lëkundur ata që shkonin në dashuri nëpër
dritaret e kullave,
janë lëkundur kullat tonë zhytura në muzgje,
po mbi të gjithë,
mbi kullat, mbi muzgjet, mbi të vrarët,

shkundej e klithë si nata,
vajtorja mbi kalin e zi.

S'i kemi lënë kurrë vajtoret të lëkundeshin mbi të
rënët.

Atyre që për vendin e tyre kanë rënë,
u kemi dhënë një grusht me dhe, një grusht me
krisma
dhe «varri me lule iu mbushtë!»

S'e kemi lënë vajtoren të lëkundej mbi të rënët,
se, po ta linim vajtoren,
si përbindësh i zi ajo
do të përkulej të na e vajtonte lirinë.

KËNGA E FYELLIT

Kënga e fyellit —

kënga jonë e gjelbër që na thirri në trollin e lagur
për liri dhe komunizëm.

Kënga e fyellit —

lëndina e plleshme që rriti barin eëmbël
nën këmbët e valleve
të dasmave tonë,

blegërimat e njoma të shqerave

që zgjodhën barin e butë, në gurgullimën e kroit,
në tërfillin e bujës.

Kënga e fyellit —

njeriu ynë që deshi të na e sillte diellin në frëngji-
të e ngushta

dhe ra si diell në krye të luginës
me plumb në rreshtë,
zemra e tij që e vumë në kaltërsinë e qiellit tonë
për ditën tonë.

Kënga e fyellit,
kënga jonë —
pavdekësish me ne.

N D A R J A

Mos kujto se sonte u lodha kaq shumë për ty,
vajzë shpirtvogël;
jo, mos kujto se erdha për ty,
jemi ndarë.

Sonte unë kam ardhur për t'i mbledhur tërë ato të
qeshura që lashë në pikëpjekjet me ty.
Të qeshurat e mia dua t'i marr,
për ty s'do të lë asgjë vec kujtimit të largët.

U dashka të flasin të tjerët për dashurinë tonë
u dashka që unë të mos gatuaj beton, të mos hap
rrugë.
Po unë dua të mos largohemi edhe 100 vjet nga
kantjeri.
Ndoshta atdheut do t'i duhet të betonojë tunele nën
dete,
ura të betonojë mbi dete e lumenj.

Sonte nga kjo pikëpjekje do të iki me tërë të qe-
shurat e mia njerëzore,
mos kujto, pra, vajzë, se erdha për ty,
se erdha për flokët gështenjë a faqet e kuqe,
sonte erdha t'i lë të qeshurat e mia pa të tuat,
si veten pa ty.

MJELESSES

Sot, kur erdha tē t'takoja ty nē stallēn e fermës,
tē përqafova pranë kundërmimit tē jonxhës së
lopëve.

Ti, duke mjelë qumësht, nga nxitimi
na i spërkate me cërka qumështi faqet,
sikur na mbinë nē faqe trëndafilë tē bardhë qumë-
shti.

Sonte, nē gjumë,
trëndafilët nē faqe m'u rritën papritur.
Flluskuan si njëmijë llampa tē bardha.

Të përqafova pranë kundërmimit tē elektrikut,
t'u dridhën duart
dhe e spërkate me drita
kaltërsinë e qiejve.

MONOLOG PARTIZAN

Poemë

Nuk e di cilët më sollën në këtë stan barinjsh
me krahë apo me shpinë,
ishte ndezur agimi mbi bjeshkët, apo kishte rënë
mbrëmja mbi konture shkëmbinjsh.
E di që beteja dje qe e vështirë,
plumbat endeshin pozicioneve e u digjinin kaçurre-
lat e gjelbra
pyjeve të mia,
nëpër këta plumba u end mjegulla e hirtë, korë e
unë humba papritur nëpër flakë e në shkëndijë.
zezë,

Kam kaq plagë në trupin tim.
Plagë në supe,
plagë në brinjë,

plagë në kofshë,
plagë e dhembje,
dhembje e gjak i ngrohtë, i ngrohtë.

Këtij mëngjezi dielli hyri nëpër vrimat e stanit e u
derdh mbi mua,
mbi plagët e mia, dhembjet e mia, ëndrrat dhe dë-
shirat e mia partizane,
si shkëlqim i butë i bjeshkëve
mbi trupin tim të shtrirë u derdhën leshrat e një
nëne,
shikimi me dritë i syve të nënës, duart e dashura
m'i ngrohën plagët,
pastaj humba sérish nëpër flakët e shkëndijat,
nëpër krismat e djeshme të armëve
u rroka me pyjet e mia, me shokët e mi, me zërin
kumbues të alarmeve,
po në çdo rrokje më përziheshin flokët e derdhura
të nënës partizane.
Të thinjura janë, po të dashura,
nëpër shpleksjen e tyre të bardhë mund të shikosh
agimet dhe purpurin e së ardhmes,
si nëpër faqet e këtij stani veror,
si nëpër pyjet e bjeshkëve
si nëpër frushullimën e gjelbër të grunjave e mis-
rave fshatare,
si nëpër pyjet e ngjeshura e solide partizane të
armëve.

Në zemrën time, në ëndrrat e mia, dëshirat e mëdha,
dhembjen e egër të plagëve
ka ra shkëlqimi i ndezur i shikimit të shokëve,
i syve të nënës, i shirjes së grurit në lëmenjtë,
i shushurimës së pyjeve, përkundjes së ujrave, kry-
qëzimit të armëve;
ka ra shkëlqimi i djeshëm, shkëlqimi i sotshëm,
shkëlqimi i vërtetë e ngadhnyses i nesërm.

Sot nëna m'i puthi faqet, sytë, flokët,
m'i puthi edhe plagët.
Unë ndjeva tek buronte nëpër buzët e saj ngrohtësia
e dashurisë së nënave
nëpër buzët e saj e ndjeva veten të lidhur me
shokët, me të afërmit, me prindërit dhe të
dashurit,
ndjeva fitoret e nesërme, dashuritë e nesërme, taki-
met, ndarjet e lumturitë e nesërme,
ndjeva zërin e nesërm pjellor të fushave dhe zhur-
mën industriale të qyteteve.
Nëpër puthjet e nënës, nëpër zërin e luftës
lianej e djeshmjë me të sotmen e të ardhmen,
E djeshmjë e zezë,
e sotmja premtuese,
e ardhmja e lumtur,
agime të bardha, të përpurta, të kuqe, të kuqe

Sot kjo nënë partizane
më lau dhembjen e sertë e rrënqethëse të plagëve.

Kur uji i freskët i maleve, ilaçi me rrëshirë e dru
pishe, fashoja e prerë nga një këmishë, si nga
një copë bore,
ranë mbi plagët e mia, dhembjet e mia.

Ndjeva, se këto dhembje vinin nga larg e ndaleshin
këtu.

Në rrugën për të nesërmen nuk do të ketë plagë,
as dhembje,
do të ketë marshime dhe shkëiqime marshimesh.

Unë nuk e dija prej nga vinte ky ujë i freskët që ra
mbi plagët e mia,
as rrëshira e pishës, as copa e prerë e këmishës.
Po nëna partizane më tregoi se ky ujë
dilte hareshëm ngre prehri i një mali ku hedhin shtat
pisha dhe ahe, ku buron buzëqeshja e larme
e luleve,
ku pushon një krua, si një djalosh i dashur
që lindi djalosh, mbeti djalosh e do të mbesë
djalosh,
lindi me këngë në gojë, mbeti me këngë në gojë
dhe do të mbesë me këngë në gojë.

Kënga e ujit vrapon e dridhshme nga një ortek bore
nëpër shpellat e shkëmbinjve dhe nëpër
zemërbutësinë e lëndinës.
kënga e ujit e rrjedhshme, e kristaltë.

Në këngën e ujit lajnë pendët, zogjtë e larmë
shuajnjë etjen delet, pyjet bijen në gjumë me
këtë këngë
e zgjohen me këngën e pa të s'mund të rrimë.
Kënga e ujit më hyri në plagë.



Nëna më tregoi se në pyllin e gjelbër ka një pishë të
moçme, të moçme,
pisha e ka trupin të gjerë e të hedhur, krahulur dhe
era nëpër krahët e saj tund pjalmin
e verdhë,
nëpër shtatin e saj rrjedh rrëshira, rrjedh e rrjedh
dhe unë e ndjeva praninë e kësaj rrëshire, dashurinë
e tokës dhe plagët e mia pranë plagëve
të saj,
e ndjeva tokën vazhdimësi timen dhe veten vazhdimësi
të tokës,
m'u kujtuan përpjekjet partizane, piskama e plumbave,
egërsia e tyre.

Kushedi sa plagë do të kisha unë dhe do të kishin
shokët,
sikur tokë mos na i merrte plumbat në trupin e saj;
kushedi sa plagë do kishte kjo tokë,
sikur të mos i merrnim në trupin tonë plagët.
Edhe një herë i ndjeva plagët e mia pranë plagëve
të tokës
gojhapura dhe zemërgjera i dhuronin jetë e gjak një-
ra-tjetrës.

Pastaj nëna më tregoi për copën e këmishës,
për copën e këmishës së bardhë që u këput nga
gjiri i një vashe të qytezës së barinjve.
Shpresa e quajnë
dhe ka shumë ëndrra, dëshira e shpresa për të ne-
sërmën;
i ka flokët bjonde sikur ka hedhur mbi to bardhësinë
jetësore të bjeshkëve,
në sy ka kaltërsinë e ditëve të nesërmë,
në mollëzat e faqeve bukuria e së nesërmës,
nga gjiri i njomë buron jeta e nesërmë.

Shpresa niset çdo mëngjez nga qyteza e barinjve
para e vë tufën e bardhë të dhenve, ëndrrat e bardha,
kaltërsinë, gjelbërimin.

Ajo do të niset një mëngjez partizane nga qyteza verore
dhe partizane do të niset nga mëngjezi i kësaj qyteze
do të ecë ajo nëpër marshimet e saj,
marshimet e saj do të jenë marshimet e të gjithëve,
sa mirë do të shohë Shpresa dritën e ditëve!



Erdhi një agim tjetër i kuq e me dritë
u derdh në këtë stan shkëlqimi i ditëve të mia dhe
i ditëve të tokës sime.

Erdhën tri silueta të gjelbëra në stanicë e parë të
qytezës baritore në lirishtë,
erdhi jeta partizane, shkëlqimi i saj i gjelbër nga-
dhënëjimi në marshime
duart e mia u takuan me të tijtë, faqet me faqet,
ditët me ditët.

Gjoksin tim e ndjeva pranë gjokseve të tjera duke
e shtyrë sintezën e dritës për ditët e
ardhme,
atje do të ngopemi me dritë e me ajër,
atje djersën tonë do ta derdhim për veten tonë e të
ardhmen tonë,
atje do të ngremë uzinat e fabrikat,
oxhakët e tyre, do t'i mbushim me tym industrial,
turnet me gjallërinë tonë dhe forcën tonë;

atje do ta përjetësojmë veprën tonë dhe veprën e
të parëve tanë
lavdisë së tyre, forcës së tyre do t'u bëjmë jehonë.

■
Ne do të dimë të gjejmë ku kemi plagë e ku na dhemb
do të dimë të kërkojmë atje ku buron dhembja e hel-
mët
dhe, nëqoftëse në rrugën tonë, në dritën tonë, do
të mungojnë shpresat,
ne do të dimë t'i gjejmë plumbat e egër që ndërprejnë
lëvizjen nëpër turnet e uzinave e fabrikave,
nëpër mëngjezet e vrullshme e pjellore fshatare,
nëpër takimet e orëve të vona
dhe do të themi:

Ja ky është plumb osman,
 ky mikroborgjez
dhe do të vinë përsëri Shpresat nëpër turne, mën-
gjezeve, takimeve, dasmave e hareve tona.

■
Përsëri zbritën agimet në stanin tim dhe i pashë duart
 e nënës mbi plagët e mia;
nga ashpërsia e duarve të saj zbriti ngrohtësia.

Mbi malet e mia zbritën horizontet e kaltra me diell,
 hënë, yje dhe dritë

mbi kroin e bjeshkës ra gjelbërimi i ëmbël nanuritës
i pyllit,
mbi trupin tim ra agimi malësor me të gjitha ngjyrat
e rrezet,
mbi plagët e dhembjet e mia duart e nënës.

Ti, nënë partizane, nënë flokëtinjur,
zbrit përsëri duart mbi plagët e mia.

Atyre duarve ua dua ashpërsinë,
atyre flokëve ua dua bardhësinë.
Je nëna ime,
edhe pse s'më ke lindur mua e ke lindur të tjerë bij.



Një ditë do të iki nga qyteza e barinjve.
Duke ikur do të përqafohem me nënën partizane,
nëpër flokët e saj, kur të shpleksen mbi mua, do t'i
shoh të gjitha agimet.

Do të iki me Shpresën partizane drejt marshimeve
dhe pastaj do të shijojmë mirë jetën, ashpërsinë e
saj, bukurinë e saj,
do ta përqafojmë shkëlqimin e grunjave dhe misrave
fshatare,

shushurimën e pyjeve dhe përkundjen e ujrate të
lumenjve,
kryqëzimin e armëve e dashurinë e njerëzve.

Pastaj në rrugën tonë do të shpalosen marshimet
tona e të vendit tonë,
asaj rruge
do të shpalosen agimet e vendit, të bardha,
të purpurta,
të kuqe,
të kuqe.

1971

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parti.	3
Me horizontet	4
Kur çeli zambaku i parë	6
Pëllumbi i hekurt	8
Kujtimi i motrës	10
Djemtë e minierës së re	12
Aktuale.	16
Zogu i Bjeshkës	18
Tetë ditët e Valbonës	19
Manushaqet e kuqe	20
Sikur ti të jesh lumiuria	22
U përkundën misrat në kraharonin e mixhës	24
Rrëmbimi	26
Dëshira pranvere	28
Ngjasimi	30
Mall	31
Na dogji malli për të rënët (poemë)	33
Pa bjeshkët	40
Tokës e gruas	42
Vajzës, që do të bëhet elektriciste	44

Faqe

Takim me pranverën	46
Pranë varrit të malazezit	48
Motiv i ri	51
Kam dalë sonte, po të pres ty të bredhi	52
O ju, korba, që më hani	54
Ëndërr e ndezur e një nate me dritë	55
Dhembje mëne	56
Korbat	57
Shiu i parë	59
Ukshin Rustemit	61
Te ky liqen	63
Gjakova	65
Takimi i parë	67
Ujvara më Klisyrë	68
Pi.	69
Vajtorja	71
Kënga e fyellit	73
Ndarja	75
Mjelëses.	77
Monolog partizan (poemë)	78